



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”  
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

## Projektet e tjera të Universitetit Publik “Kadri Zeka”

### 11.4.32 Projekti KODE

UKZ është pjesë e Projektit KODE/NREN, të financuar nga Banka Botërore për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e punësimit përmes përfshirjes së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në veçanti mundësitë të qasjes në resurse të teknologjisë dhe dijes për studentë dhe profesorë të të gjitha universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë. Qëllimi i këtij Projekti është ngritja dhe zhvillimi i komunitetit të hulumtuesëve dhe zhvillimi i edukimit në Kosovë, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe mundësitë që ofron “Rrjeti Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim i Kosovës”, i cili pretendon që të arrij këtë zhvillim duke i siguruar këtij komuniteti qasje në resurse të ndryshme digjitale, si: qasje në infrastrukturë moderne të teknologjisë së informacionit, shërbime të ndryshme digjitale, qasje në literaturë, si dhe të ofrojë bashkëpunim në mes të institucioneve arsimore brenda dhe jashtë kufirit të Kosovës. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është duke e zbatuar Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), të financuar nga Banka Botërore dhe bashkë me Rrjetin për Hulumtim dhe Edukim të Kosovës (Kosovo Research and Education Network -KREN), kanë për mision mbështetjen dhe lehtësimin e kërkesave të komunitetit shkencor, edukativ dhe hulumtues, duke synuar një transformim digjital dhe nxitje në inovacion. Rrjeti kombëtar për hulumtim dhe edukim është duke ndihmuar universitetet në zhvillimin e inovacionit, hulumtimit dhe edukimit në Kosovë. Nëpërmjet këtij projekti do bëhet gjithashtu lidhja me rrjetin ndërkombëtar GEANT.

### 11.4.33 Projekti OPTIMA

Nga Programi i Ambasadës Amerikane për mbështetje të Universiteteve, UKZ është pjesë e Projektit OPTIMA, i cili ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të performances së

mësuesve akademikë për sistemin Universitar të arsimit të lartë publik në Kosovë. Poashtu në kuadër të projektit, parashihet që të plotësohen nevojat specifike të universiteteve si dhe të adresohen shqetësimet e stafit akademik dhe të administratës në secilin universitet. Në projekt planifikohet që modeli të përfshijë edhe standardet dhe udhëzimet e duhura për cilësinë akademike dhe mësimdhënies siç përcaktohet nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe AKA. Objektivat kryesore të programit kanë qenë duke arritur rezultate në: Marrjen e njohurive nëpërmjet rishikimit dhe vlerësimit të shtatë universiteteve publike mbi statutin e tyre në adresimin e standardeve të AKA-së për vlerësimin e punës së stafit akademik. Objektiv tjetër është arritja e koncenzusit për qëllimet e përgjithshme dhe qasjen e unifikuar për zhvillimin e një procesi të evaluimit të stafit akademik si dhe të hartohet një plan gjithëpërfshirës, që do të përdor një proces shumëhapësh për t'u zbatuar në çdo universitet sa i përket standardeve të akreditimit të AKA-së.

#### **11.4.34 Projektet me GIZ**

GIZ gjerman ka qene gjithmonë në mbështetje të iniciativave nga stafi i UKZ-së. Falë bashkëpunimit të mirë kemi arritur të organizojmë tre konferenca lidhur me pilot projektin “Klasa 1 deri 5- Një apo më shumë mësues”. Idenë për këtë projekt e ka dhënë stafi UKZ-së, i cili ka organizuar tri tryeza debatuese, ku ka ftuar personat përgjegjës si mësues, prindër, psikolog, përfaqësues të institucioneve. Janë diskutuar shumë aspekte se a do të mund të implementohet dhe a është i mirë për fëmijët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore. Ky projekt ka filluar të implementohet fillimisht si pilot në një shkollë fillore në Gjilan, dhe pas dy viteve, është zgjeruar edhe në disa shkolla tjera në Gjilan dhe në disa qytete të tjera në Kosovë. Pas një viti të implementimit, është mbajtur konferenca, ku janë prezantuar të gjeturat nga hulumtimi në shkollën ku ka filluar të implementohet.

Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ, gjithashtu është mundësuar që të zhvillohen edhe disa trajnime me studentë dhe profesorë të Fakultetit të Edukimit. Janë mbajtur dy trajnime për studentë të Fakultetit të Edukimit “Vlerësimi Sumativ dhe Hartimi i Testit 1-9”. Poashtu studentët dhe profesorët e UKZ-së janë trajnuar për programin e hulumtimit dhe nxjerrjen e të dhënave “SPSS”. Dhe në përfundim të projektit GIZ ka financuar edhe të gjitha programet e veta të trajnimit për Institutin e UKZ-së, duke i dhënë të gjitha programet e trajnimit Institutit të Fakultetit të Edukimit,

me qëllim që Instituti të fillojë trajnimet e mësuesve në module të ndryshme, duke filluar edhe certifikimin e tyre dhe poentimin gjithashtu.

#### **11.4.35 Projekti Up to Youth**

Ky projekt financohet nga USAID dhe është i shtrirë në 9-të komuna të Republikës së Kosovës, ku do të angazhon rreth 40 të rinj. Projekti “Up Up Youth” i financuar nga USAID funksionon me të rinjtë e Kosovës nga mosha 16-24 vjeç të cilët janë të prekshëm nga përjashtimi social, duke i mobilizuar dhe fuqizuar ata për një ndikim pozitiv në shoqëri. Projekti synon rininë e margjinalizuar, veçanërisht ata të nënvlerësuar nga iniciativat kapitale, me stres dhe traumë të pa adresuar, ose të prekshme nga zhvillimi i sjelljeve të rrezikshme. Programi punon për ndërtimin e aseteve dhe agjencive rinore, duke mundësuar të rinjtë të kontribuojnë dhe luajnë role udhëheqëse në komunitetet e tyre, duke ndërtuar dhe mbështetur rrjete dhe një mjedis që ofron mundësi për zhvillim pozitiv të të rinjve.

Qëllimi i projektit është të ndikojë pozitivisht te të rinjtë, të cilët nën moshën 24 vjeç përbëjnë 42% të popullsisë së Kosovës, nga ta 52% janë të pa punë dhe 30% i takojnë ekonomisë joformale. Duke u mbushur me ambicie dhe dëshirë për t’u integruar plotësisht në ekonominë globale, ndërsa janë të irrituar nga mundësitë që kanë në dispozicion, rinia do të luajë një rol kryesor në përcaktimin e të ardhmes politike dhe ekonomike të Kosovës, dhe zëri juaj të dëgjohet.

#### **11.4.36 Projektet e studentëve në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike/fushën e digjitalizimit**

Në kuadër të fakulteteve organizohen edhe punë hulumtuese e shkencore edhe nga ana e profesorëve dhe studentëve.

UKZ dhe Komuna e Gjilanit kanë arritur bashkëpunim për digjitalizimin e shërbimeve të Stacionit të Autobusëve dhe shkollave të mesme në Gjilan. Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë prezantuar punën e tyre në përpilimin elektronik të orarit mësimor, ueb faqes së shkollave, digjitalizimin të punës dhe shërbimeve në stacionin e autobusëve si dhe aplikacionin për menaxhimin e pagesave dhe shërbimeve hoteliere me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për publikun me këtë rast shkollat dhe ndërmarrjet, e në të ardhmen edhe institucionet tjera publike dhe rrjetin e bizneseve në përgjithësi.

Vetëm në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në lëndën e Projektit hulumtues, e cila është lëndë mësimore obligative në semestrin e tretë janë bërë këto projekte:

- Komunikimet ndërmjet kompjuterit, pllakës elektronike Arduino Uno, Serial Monitor dhe VT 100, me programim në C++
- Ndërtimi i sistemit për kyçjen e çkyçjen e LED diodave të displeit 7 segmentësh duke programuar mikrokontrolerin ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit në prezentimin e shkronjave A, B, C, E dhe F në kohë të caktuar në displein 7 segmentësh në kohë të caktuar dhe programimi i mikrokontrolerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit digjital përmes të cilit kryhet prezentimi numerik nga 99 gjer në 0 duke përcjellur punën e semaforit në udhëkryq dhe programimi i mikrokontrolerit ATMEGA 328P në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i sistemit përmes të cilit 6 LED dioda me ngjyra të ndryshme ndriçojnë në kohë të caktuar dhe për një kohë tjetër nuk ndriçojnë, duke programuar mikrokontrolerin në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për prenotime të hapësirave hotelierike
- Ndërtimi i sistemit digjital përmes të cilit lexohen kodet e RFID kartelave përmes USB Reader dhe evidenton hyrjet e daljet e studentëve në salla mësimi në UKZ, duke programuar në gjuhën programuese C++
- Ndërtimi i WEB faqes për: reklamimin Shitjen dhe distribuimin e barnave popullore të një farmacie popullore
- Ndërtimi i aplikacionit për caktimin e numrit të ulëseve të fituara në Asamblenë Komunale në zgjedhjet lokale në Luginë të Preshevës sipas sistemit të Dontit!
- Ndërtimi i sistemit digjital kopshti i “mençur” përmes pllakës elektronike Arduino Uno me mikrokontroler ATMEGA 328P dhe programimi i tij në gjuhën programuese C++
- Zhvillimi evolutiv i PC në raport me zhvillimet në Sisteme të shpërndara kompjuterike
- Disa protokolle më të rëndësishëm në shtresën e aplikacionit dhe simulimi i tyre përmes Packet Tracer
- Baza të dhënash dhe Siste të shpërndara, Data Lake
- Krijim i disa qareve dixhitale të kombinuara përmes elementeve logjike AND (7409), OR(7432) dhe NOT

- Aplikimi i Google suite për punë ekipore në dokument tekstual, tabelar, prezantues dhe ueb
- Mikrokontroleri Arduinouno, përshkrim hardverik, softveri dhe programimi me C++ i disa projekteve praktike
- Roli i ruterit në WAN, zhvillimi evolutiv i tyre, konfigurimi dhe një simulim përmes Packet Tracer
- Uebaplikacioni "Vullnetarët e Shkencave Kompjuterike"
- Uebaplikacioni "Gjeje një zhvillues për projekt"
- Uebaplikacioni "Biçikleta për huazim"
- Uebaplikacioni "Turizmi në Kosovë"
- Ndikimi i Vizualizimit dhe Procesimit të Imazheve në Mjekësi.
- Roli i Memories në Grafiken e Kompjuterëve

#### **11.4.37 Projektet me HERAS**

UKZ ka qenë pjesë e 2 projekteve në HERAS dhe 2 projekteve në HERAS+:

Në mbështetje nga WUS Austria, programi HERAS në Kosovë, UKZ, gjegjësisht stafi dhe studentët kanë qenë përfutues të dy projekteve, të cilat janë financuar plotësisht nga ky program. Projekti i parë ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve në ndërkombëtarizim dhe në shkrim të projekteve në universitetet e reja publike në Kosovë. Koordinator i këtij projekti ka qenë Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Salzburg të Austrisë, ndërsa është udhëhequr nga UKZ. Në kuadër të këtij projekti, është realizuar vizita studimore në po këtë universitet më përfaqësues nga menaxhmenti i secilit universitet partner në Kosovë. Gjithashtu janë mbajtur edhe trajnime të ndryshme me stafin akademik dhe administrativ të secilit universitet. Projekti tjetër i financuar nga HERAS është ai i studentëve të Fakultetit Juridik me temën "Personat pa shtetësi dhe ndikimi i tyre në universitet". Sipas këtij projekti, është realizuar hulumtimi dhe anketa me qytetarë që nuk kanë shtetësi dhe në fund janë prezantuar edhe rezultatet e këtij hulumtimi dhe të njëjta i janë dërguar institucioneve përgjegjëse për të ndërmarr hapat e nevojshëm për të zgjidhur këtë çështje.

#### **11.4.38 Projektet me HERAS Plus**

Në kuadër të projektit HERAS+ janë fituar projekti për mbështetje për organizimin e dy punëtorive për rishikimin e Planit Strategjik së UKZ-së, si dhe ofrimi i një eksperti të HERAS+ në ndihmën për rishikimin e Planit Strategjik. Poashtu HERAS+ me projektin tjetër do të mbështesë edhe dy punëtoritë tjera për UKZ, me qëllim të hartimit të Raportit të Vetëvlerësimit Institucional të UKZ-

së si dhe do të ofrojë një ekspertë për UKZ-në me qëllim të ofrimit të ekspertizës në përpilimin e këtij raporti.

#### **11.4.39 Projekti me US Alumni Association**

Në kuadër të projektit me KUSA, Ambasada Amerikane ka financuar tetë studente femra nga FJu i UKZ-së që të kryejnë punë praktike me pagesë në institucione të ndryshme relevante të drejtësisë në Prishtinë. Tetë studente femra nga FJu, të gjitha me notë mesatare mbi 9 kanë kryer me sukses punën praktike nëpër institucionet respective, madje disa prej tyre edhe janë punësuar në to.